



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 16 prot.

Kamëz, më 26. 2. 2026

V E N D I M
Nr. 15 .Datë 26 / 2 2026
MBI

“NJË NDRYSHIM TË VENDIMIT NR. 3 DATË 26.01.2026 MBI “MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE DHE VLERËS SË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR ATO FAMILJE NË NEVOJË QË NUK MUND TË PËRBALLOJNË QIRANË PER VITIN 2026”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 26.2.2026, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.12 Datë 23.02.2026 në mbështetje të Kushtetutës, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social” i ndryshuar, Ligji për Kodin Administrativ në Republikën e Shqipërisë, Vendimit nr. 301, datë 15.04.2020, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit”, Vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM nr.362 date 20.05.2019 “Për kriteret e dhënies subvencionimit qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”; Udhëzim nr.31 dt.18.11.2019 “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti shtetit për programet e strehimit”; Vendimit nr.133 datë 24.10.2022, të Këshillit Bashkiak “Për ngritjen e Komisionit të Strehimit”; Vendimit nr.75 datë 14.11.2025 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e manualit të subvencionimit të qirasë në Bashkinë Kamëz për familjet që nuk mund të përballojnë pagesën e qirasë”; VKB nr 90 dt.17.12.2025 për “Miratimin e detajimit të buxhetit të vitit 2026, 2027, 2028”; VKB Nr.3 datë 26.01.2026 ; **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit të tabelës nr.4 të Vendimit nr. 3 datë 26.01.2026 mbi trajtimin me subvencionin e qirasë për individët/ familjet, sipas listës bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Kohëzgjatja e pagesës së qirasë për individët/familjet e përcaktuara në pikën 1, do të jetë për një periudhë një vjeçare duke filluar nga data 01.01.2026 deri në datën 31.12.2026.
3. Efektet financiare që rrjedhin nga pika 1 *do të përballohen me bashkëfinancim në raportin 50% nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe 50% nga buxheti i Bashkisë Kamëz.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

4. Të ngarkojë Drejtorinë e Financës dhe Kontabilitetit, Drejtorinë e Emergjencave Civile dhe Strehimit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimit të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI

